



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. Br. Prot. 03-03/1588/18  
Prot. No.  
Data Datum 07.06.2018  
Date  
Nr. pages 03  
PRISHTINE

DATË/A:	07.06.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1566/18
PËR/ZA/TO:	z. Zekrija DUSHI, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit – Radio Televizioni i Kosovës
CC:	z. Mentor SHALA, Drejtor i Përgjithshëm – Radio Televizioni i Kosovës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Regjistrimi i veturave të RTK-së "

*I nderuari z. DUSHI,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull " **Regjistrimi i veturave të RTK-së** " me nr. të prokurimit: RTK-18-3892-221, dhe me nr. të brendshëm: RTK-18-264-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

## OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Regjistrimi i veturave të RTK-së** " me nr. të prokurimit: RTK-18-3892-221, dhe me nr. të brendshëm: RTK-18-264-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

## Arsyetime

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 06.06.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: *AKK-03-03-1566/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull “ *Regjistrimi i veturave të RTK-së* ” me nr. të prokurimit: *RTK-18-3892-221*, dhe me nr. të brendshëm: *RTK-18-264-221*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Radio Televizioni i Kosovës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike të llojit shërbime për sigurimin e automjeteve zyrtare të RTK-së, me vlerë të mesme në shumë prej 11.000,00 €.

Agjencia, gjatë analizimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka vërejtur se tek rubrika III.2.4. *Kapaciteti teknik/profesional* është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar me sukses minimum dy kontrata për shërbimet të natyrës së njëjtë në tri vitet e fundit. Ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare: është kërkuar lista e kontratave për shërbimet e natyrës së tillë-së paku 2 kontrata të përfunduara me referenca të realizuara gjatë periudhës së shkuar tri vjeçare, duke saktësuar shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës vlera e kontratës jo më e vogël se 22,000.00 €. Kërkesë kjo për të cilën Agjencia, gjithashtu konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2. listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë.

Pra në këtë rast do duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale të gjitha referencave të shërbimeve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë e jo si në rastin konkret ku është kufizuar numri i kontratave në vlerë prej 22.000,00 €.

Lidhur me kërkesën më lartë, Agjencia gjithashtu ka vërejtur se kërkesa në lidhje me numrin e kontratave mundet të krijoj konfuzion tek operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar për



të tenderuar në këtë aktivitet të prokurimit, kjo për faktin se Operatori ekonomik nuk e ka të qartë se a janë kërkuar një apo dy kontrata në shumën prej 22.000,00 €.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë shërbime të tilla të kënaqshme.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Aftësia teknike/profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*

